

**RAPORT I AUDITORES TE PAVARUR  
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENZUARA  
PER FUSHATEN ZGJEDHORE, PER ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE  
TE SHQIPERISE PERIUDHA 21.06.2015**

---

**RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR PËR QËLLIME TË VEÇANTA  
PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA PARTIA  
“LEVIZJA PER DREJTESI E SHQIPTAREVE”**

Tirane më, 24 Tetor 2015

## Tabela e përmbajtjes

**RAPORTI I VEÇANTË I AUDITIT TË PAVARUR**  
**PASQYRA E TË ARDHURAVE (Financimet dhe Donacionet)**  
**PASQYRA E SHPENZIMEVE (Përdorimi i fondeve sipas destinacionit)**

### Referencat ligjore:

Për kryerjen e këtij misioni jemi mbështetur në përputhje me:

Standartet Ndërkombëtare të Auditimit me referencë të veçantë SNA 800.

Ligjin nr.10019.datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Ligjin nr.10091.datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar"

Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“

Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë

**RAPORT I AUDITORES TE PAVARUR**  
**PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENZUARA**  
**PER FUSHATEN ZGJEDHORE, PER ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE**  
**TE SHQIPERISE DATE 21.06.2015**

---

**RAPORT I AUDITUSIT MBI ANGAZHIMET E AUDITIMIT PËR QËLLIME TË VEÇANTA.**

**MBI AUDITIMIN E SHPENZIMEVE TË PARTISË “LEVIZJA PER DREJTESI E SHQIPTAREVE”**

**Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve**

**Të nderuar zotërinj**

Unë, Alida Daija në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Autorizuar (Auditor i pavarur) jam caktuar me Vendimin e nr.969 date 10.08.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe Kontratës së Shërbimit nr.7711 të dates 29.09.2015, për kryerjen e auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të Shqipërisë të dates 21.06.2015 të Partisë “LEVIZJA PER DREJTESI E SHQIPTAREVE”.

Une kam audituar pasqyrën (deklaratën) bashkëlidhur të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të Shqipërisë për periudhën 21.06.2015.

Kjo pasqyrë (deklarata) është përgatitur nga Partia “LEVIZJA PER DREJTESI E SHQIPTAREVE” bazuar në librin e llogarive të Partisë dhe të regjistrit të posaçëm, miratuar si model me vendimin e KQZ-së, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjitha transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore , që kanë dhënë bazën për përgatitjen e pasqyrës së arkëtimit – pagesave.

Drejtimi i subjektit zgjedhore është përgjegjës për paraqitjen e sinqerte të burimeve të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara në përputhje me kodin zgjedhor dhe standarteve kohore të kerkuara. Kjo përgjegjësi përfshin : deklarimin e burimeve të fondeve të përfituara nga subjekte publike dhe jopublike , publikimin e peronave fizik dhe juridik vendas për dhurimet e formave të ndryshme mbi vlerën 100 000 leke, justifikimin e shpenzimit të fondeve të përfituara me dokumenta që përcaktohen në legjislacionin tatimorë, zbatimin korrekt të kërkesave sipas përcaktimit të bërë në kapitullin e financimeve të fushatës në Kodin Zgjedhor.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin tim.

Unë kam kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit në referencë të veçantë me SNA 800 (raporti i auditorit për angazhime auditimi me qëllime të veçanta). Këto standarte kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të zotëruar siguri të arsyshme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare të arkëtimit-pagesave Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në deklaratimet e subjektit zgjedhore në lidhje me burimin e fondeve të perfituara nga subjekte publike dhe jopublike, justifikimin e shpenzimit të fondeve të perfituara me dokumenta që percaktohen në legjislacionin tatimor. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali materiale në deklaratimet, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimit.

Ne zbatim të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë :

Neni 87 "Shpërndarja dhe rishpërndarja e fondeve publike për subjektet zgjedhore" pika 2 shpreh " Sasia e fondeve publike që i shpërndahet secilit prej subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të KQZ-së, sipas rregullave të mëposhtme"

Nga ana jone u konstatua :Subjekti zgjedhor nuk ka fituar fonde publike.

Neni 89 pika 1 shpreh:

Subjektet zgjedhore mund të marrin, për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore, fonde vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Për qëllim të këtij Kodi, konsiderohet person fizik vendas edhe shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Nga ana jone u konstatua :Subjektit zgjedhor rezulton se nuk ka perfituar fonde për fushatën, nga subjektet fizike dhe juridike vendas.

Neni 89 pika 2 shpreh:

Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlefata në sende ose shërbime.

Nga ana jone u konstatua : Subjekti rezulton se nuk ka perfituar fonde per fushaten, nga subjektet fizike dhe juridike vendas.

Neni 89 pika 3 shpreh:

Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

- a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë;
- b) ushtron veprimtari në fushen e medias.
- c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;
- ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.

Nga ana jone u konstatua :

Subjektit rezulton se nuk ka perfituar fonde per fushaten, nga subjektet fizike dhe juridike vendas.

Neni 90 pika 1 shpreh:

Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 89 të këtij Kodi dhe mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për t'u nënshkruar në çdo rast dhurimi. Lista e personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse duhet të bëhen kurdoherë publike.

Nga ana jone u konstatua :

- a)Subjekti zgjedhor ka mbajtur rregjister te posaçem sipas modelit te miratuar nga KQZ.

Neni 90 pika 2 shpreh:

Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor, jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Nga ana jone u konstatua :

a) Subjekti nuk ka çelur llogari Bankare te veçant per financuesit jopublik

Neni 90 pika 3 shpreh:

Shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 87 të këtij Kodi. Çdo shpenzim i kryer për fushatën zgjedhore dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.

Nga ana jone u konstatua :

Subjekti nuk ka perfituar fonde publike dhe per rrjedhoj shpenzimet e kryera nga subjekti ,nuk mund te kene alternativ krahasimi.

Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrën financiare mbi bazën e arkëtimeve dhe pagesave.

Subjekti zgjedhor deklaron se nuk ka perfituar asnje fond publik dhe jopublik dhe nuk ka bere shpenzime.

*Unë çmoj se evidenca e auditimit që unë kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtateshme për të dhënë një bazë të opinionin tim të auditimit.*

*Për mendimin tim, pasqyra e fondeve të përfituar dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore të Shqipërisë për periudhën 21.06.2015 të Partisë "LEVIZIA PER DREJTESI E SHQIPTAREVE " eshte përgatitur në respekt te ligjit dhe ne përputhje me Kodin Zgjedhor te Republikes se Shqiperise.*

**Alida Daija**  
**Eksperte Kontabile e Rregjistruar**

Tiranë , më 24.10.2015

Adresa: Rr Ali Pashe Gucia nr.90 Tirane  
Cel : 0692041693  
E-mail:alidadaija@yahoo.com

  
" ALIDA DAIJA "  
EKSPERT KONTABEL  
REANI - TIRAR LIC144

**PASQYRA E TE ARDHURAVE SHPENZIMEVE PER FUSHATEN ZGJEDHORE 21 QERSHOR 2015  
PARTIA "LEVIZJA PER DREJTESI E SHQIPTAREVE"**

<b>TE ARDHURAT</b>	
<b>Burimi I te Ardhurave</b>	
Fondi financiar nga buxheti për fushatën zgjedhore	
Fondet e Partise	
Fonde të dhuruara nga persona fizik për fushatë	
Fonde të dhuruara nga persona juridike për fushatë	
<b>Totali I te ardhurave</b>	
<b>SHPENZIMET</b>	
1- Botim gazetash	
2- Karburant,	
3- Prgatitje dhe montim banerash	
4-Eventet e fushates	
5-transport materialesh dhe personash	
6-postera ,fletepalosje,kartvizita	
7-kancelari	
8- Paisje zyresh elektorale ne rrethe	
9-Reklame spote Televizive	
10-Materiale te ndryshme	
11- konsulenca	
12- Te tjera	
<b>Totali I shpenzimeve</b>	
<b>Mbetja (te ardhura minus shpenzime)</b>	

Per Partine "Levizja Per Drejtesi e Shqiptareve"

Astrit Kosturi  
Kryetari

